# DËSHMI ARKIVI

**A-474479**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Përpara ndeshjes me Turqinë: Nuk kemi presion, shoh shumë shqetësim. Edhe para Evropianit që fituam nuk kishte besim |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sport/perpara-ndeshjes-me-turqine-nuk-kemi-presion-shoh-shume-shqetesim-edhe-par-i588798` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 17:54:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 17:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `55eb483bc662ff3303aac981315a85ad9f96502c710a854f21620fc764a1ee2c` |
| TEKSTI | `161922d92eedb8f37c1d88d2c279de1f12e59bd841dbc822137388530f573df1` |
| PAMJA | `d164615aa6e80e13b09a9550665d896a89831f2ba10492732c357e69da46fbb5` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7cca977da5adccf880a633738a4381845439c77b433bab3482c879f36259a03c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7cca977da5adccf880a633738a4381845439c77b433bab3482c879f36259a03c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Built and Monetized by

English



# Përpara ndeshjes me Turqinë: Nuk kemi presion, shoh shumë shqetësim. Edhe para Evropianit që fituam nuk kishte besim

TemA

27 Shtator 2026, 19:50Sport TEMA



Trajneri Roberto Mancini bëri apel për ruajtjen e qetësisë në lidhje me kombëtaren italiane. Pas humbjes me Belgjikën në Olimpico në ndeshjen e parë të Nations League, Të Kaltrit u bënë tabelë qitjeje e kritikave të shumta nga tifozët dhe jo vetëm dhe tani do të luajnë ndaj Turqisë, një sfidë që është përkufizuar si një lloj playoffi.

*'Në duhet të vazhdojmë të rrimë të qetë, pa nervozizmin që po shoh vërdallë*-tha Roberto Mancini në një intervistë për SkyTG 24-*futbolli përbëhet nga episode. Mbrëmjen e së premtes gjërat mund të kishin ndryshuar në pjesën e dytë, por Belgjika fitoi me meritë. Të rinjve iu duhet dhënë kohë, Romano më pëlqeu, bëri një ndeshje të mirë, përtej gabimit që mund ta bëjnë të gjithë'*

Tani është Turqia, ku Mancini pranoi se mund të bëjë ndonjë ndryshim në formacion.

*'Tani në Turqi, kemi mundësinë që të ndryshojmë diçka dhe mbase edhe ndonjë futbollist, sepse në këto nivele nuk mund të luhen 4 ndeshje kaq pranë njëra tjetrës*-vijoi Mancini-*Montella ka një skuadër shumë të fortë, plot me talente, do të jetë e vështirë'.*

Trajneri Mancini po kështu largoi edhe të gjithë presionin nga skuadra e tij.

*'Presion pas humbjes me Belgjikën? Asnjë, është një ndeshje futbolli. Nesër do të kërkojmë të luajmë mirë dhe të fitojmë*-shtoi ai në një intervistë për RaiSport-*edhe kur fituam Evropianin, përpara saj nuk kishte besim. Nuk ishim mes 6-7 skuadrave favorite. Duhet vetëm të punojmë dhe t'u japim kohë të rinjve. Për fat të keq, në klube nuk kanë shumë kohë për të luajtur ndeshje të këtij niveli, duhet t'u japim kohë'*

Roberto Mancini foli edhe për Sportmedasiet ku foli qartë për ringritjen e kombëtares italiane

*'Kombëtarja Italiane nuk mund të rilindë me 2 stërvitje*-tha Mancini-*e dinim që do të hasnim në vështirësi. Po vlerësojmë të gjithë futbollistët, sidomos më të rinjtë për të kuptuar nëse mund të qëndrojnë me ne apo jo. Ecuria në Nations League? Kemi edhe 5 ndeshje, gjithçka mund të ndodhë'.*

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Not, çiklizëm dhe vrap/ U mbajt edicioni i 6-të i ‘Tiranathlon’ - Në garë morën pjesë 116 sportistë nga bota]

18:50 Sport

[Pas fitores me Bjellorusinë, kuqezinjtë vijojnë përgatitjet për duelin ndaj San Marinos]

17:30 Sport

[Skandali financiar në Angli: Klubet e Premier League përgatisin padi 930 milionë euro kundër Manchester City-t]

13:40 Sport

[Asllani dhe Muçi i japin kuqezinjve fitoren ndaj Bjellorusisë]




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.